



-III- Nr. i prot. 742 Më 13.03.2019
 Br. prot. Dt.
RAHOVEC - ORAHOVAC

Në mbështetje të Ligjit Nr.03/L-048, për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin Nr 03/L222 dhe Ligjit Nr 04/L-116 nenin 58, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, Nr 03/L040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, 28/2008), nenit 5,7 dhe 8 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve Nr.1427 e datës 28.04.2017, dispozitat e nenit 8,10,12 dhe 16 të Rregullores MF-Nr 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve nenit 74, dhe nenit 92, paragrafi 4, të statutit të komunës Nr 1005 i datës 29.03.2017 dhe Thirjes Publike të datës 08.02.2019, bazuar në vendimin Nr 01/78/19 të datës 07.03.2019 për formimin e Komisionit, për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Aplikacioneve për Ndarje të Subvencioneve nga DKRS-ja për vitin 2019, Komisioni Vlerësues nxjerr këtë:

V E N D I M

- Në përputhje me afatet, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit vlerësues të përcaktuara me Rregulloret e lartëcekura dhe vendimit të Kryetarit të Komunës dhe mbi bazën e thirjes Publike të datës 08.02.2019, Komisioni ka shqyrtuar dhe vlerësuar të gjitha aplikacionet dhe dokumentacionin përkatës të dërguar nga OJQ-të, ku sipas kriterëve, Komisioni Vlerësues ka shpallur fitues për Subvencionim këto OJQ:

NR EMRAT E OJQ-VE

SHUMA

1.1 KB RAHOVECI	40,000.00
1.2 SHKOLLA E FUTBOLLIT RAHOVERI.....	1,500.00
1.3 SHOQATA E PEDAGOGËVE TË KULTURËS FIZIKE	500.00
1.4 KF RAHOVECI.....	24,000.00
1.5 KLUBI I SHAHUT RAHOVECI.....	1,500.00
1.6 KF BASHKIMI.....	4,000.00
1.7 SHOQATA E PESHKATËRVE AMUR.....	800.00
1.8 SHKOLLA E FUTBOLLIT DRENOCI.....	800.00
1.9 KF XËRXA.....	4,000.00
1.10 KF DEJNI.....	4,000.00
1.11 AUTO MOTO.....	900.00

- Pas kalimit të afatit ankesave dhe procedurave tjera të parapara në rregulloret e lartëcekura, Kryetari i Komunës do të lidh kontratat me përfituesit e mjeteve financiare me të gjitha OJQ-të përfituese.

ARSYETIM

Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të, brenda afatit të përcaktuar ka bërë hapjen dhe vlerësimin e çdo aplikacioni, dhe në përputhje me Rregulloret e lartëcekura, ka bërë hapjen dhe vlerësimin e çdo aplikacioni dhe mbi bazën e thirrjes publike nga 13 aplikacione, kriteret i kanë plotësuar 11 (njëmbëdhjetë) OJQ. Në përputhje me detyrat, përgjegjësitë dhe afatet e komisionit të përcaktuara në Rregulloret e lartëcekura dhe duke vlerësuar secilin aplikacion dhe projekt të OJQ-ve, veç e veç sipas thirrjes publike të datës 08.02.2019.

Nga se u tha më lartë Komisioni ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Udhëzim Juridik: Kundër këtij vendimi lejohet ankesë në afat prej 5 ditësh, pranë Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Ankesave të OJQ-ve në Komunën e Rahovecit.

KOMISIONI:

1.Arsim Kastrati,Kryesues

2.Njomëza Fazliu,anëtare

3.Ardian Rama ,anëtar

4.Halil Selmani,anëtar

5.Arbnore Sokoli,anëtare

